<p style="text-align: center;">Neni 31 Korrigjimi i përbërësve të gjendjes civile</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Correction of civil status components</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Ispravka komponenti građanskog statusa</p>
<p>1. Nëse gjatë regjistrimit të përbërësve të</p>	<p>1. If during the registration of the civil status</p>	<p>1. Ako su prilikom upisa sastavnih delova civilnog</p>

<p>gjendjes civile në regjistrat e gjendjes civile janë bërë gabime drejtshkrimore, gabime në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme dhe të dukshme, të dhënat e gjendjes civile mund të korrigjohen.</p> <p>2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, numri personal nuk mund të korrigjohet.</p> <p>3. Zyrtari i gjendjes civile bën korrigjimin në këto raste:</p> <p>3.1. me kërkesën e personit;</p> <p>3.2. sipas detyrës zyrtare;</p> <p>3.3. kur vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.</p> <p>4. Rregullat e detajuara për mënyrën e korrigjimit të përbërësve të gjendjes civile, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>components in the civil status registers spelling errors, calculation errors and other similar, obvious inaccuracies were made, the civil status data can be corrected.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, the personal number cannot be corrected</p> <p>3. The civil status official shall make the correction in these cases:</p> <p>3.1. at the request of the person;</p> <p>3.2. ex-officio;</p> <p>3.3. when confirmed, in all other cases, by a court decision.</p> <p>4. The detailed procedure and rules for the correction of the civil status components shall be defined by a sub-legal act approved by the Minister.</p>	<p>statusa u regjistrima civilnom statusu učinjene pravopisne greške, računске greške i druge slične greške, očigledne netačnosti, podaci o civilnom statusu se mogu ispraviti.</p> <p>2. Izuzev stava 1. ovog člana, lični broj se ne može ispravljati.</p> <p>3. Službenik za civilno stanje vrši ispravku u sledećim slučajevima:</p> <p>3.1. na zahtev lica;</p> <p>3.2. po službenoj dužnosti;</p> <p>3.3. kada je potvrđeno, u svim ostalim slučajevima, odlukom suda.</p> <p>4. Procedura i detaljna pravila o načinu ispravljanja komponenti civilnog statusa utvrđuju se podzakonskim aktom usvojenim od strane ministra.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli 2</u> <u>Ndërrimi i përbërësve të gjendjes civile</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Ndërrimi i përbërësve të gjendjes civile</p> <p>1. Përbërësit e gjendjes civile që mund të</p>	<p style="text-align: center;"><u>Subchapter 2</u> <u>Change of Civil Status Components</u></p> <p style="text-align: center;">Article 32 Change of civil status components</p> <p>1. The components of civil status that can be</p>	<p style="text-align: center;"><u>Podpoglavlje 2</u> <u>Promena komponenti građanskog statusa</u></p> <p style="text-align: center;">Član 32 Promena komponenti građanskog statusa</p> <p>1. Komponente građanskog statusa koje se mogu</p>

<p>ndërrohen sipas këtij ligji janë:</p> <p>1.1. emri personal;</p> <p>1.2. gjinia;</p> <p>1.3. raportet e atësisë/amësisë;</p> <p>1.4. statusi martesor; dhe</p> <p>1.5. vendbanimi.</p> <p>2. Ndërrimi i përbërësit sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.3 të këtij neni bëhet sipas dispozitave të ligjit përkatës mbi familjen.</p> <p>3. Ndërrimi i përbërësit sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.4 të këtij neni bëhet me regjistrim, përkatësisht shuarjes së martesës, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për familjen.</p> <p>4. Kriteret dhe rregullat për ndërrimin e përbërësve si në paragrafin 1, nënparagrafin 1.5 të këtij neni, rregullohen me ligjin përkatës për vendbanim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Ndërrimi i emrit personal</p> <p>1. Shtetasi mund të ndërrojë emrin personal,</p>	<p>changed according to this law shall be:</p> <p>1.1. personal name;</p> <p>1.2. sex;</p> <p>1.3. paternity/maternity relationships;</p> <p>1.4. marital status; and</p> <p>1.5. domicile.</p> <p>2. Change of the component according to paragraph 1.3. of this article shall be done according to the provisions of the relevant Law on the family.</p> <p>3. The change of the component according to point 1.4 of this article shall be done by registration, namely the dissolution of the marriage, in accordance with the provisions of the relevant law on the family.</p> <p>4. Criteria and rules for changing components as in paragraph 1.5. of this article shall be regulated by the relevant law on domicile special law.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Change of the personal name</p> <p>1. A citizen may change his/her personal name,</p>	<p>promeniti prema ovom zakonu su::</p> <p>1.1. lično ime;</p> <p>1.2. pol;</p> <p>1.3. odnosi očinstva/materijalstva;</p> <p>1.4. bračno stanje; i</p> <p>1.5. prebivalište.</p> <p>2. Promena komponente prema stavu 1.3. ovog člana vrši se prema odredbama relevantnog zakona o porodici.</p> <p>3. Promena komponente prema stavu 1.4 ovog člana vrši se upisom, odnosno prestankom braka, u skladu sa odredbama relevantnog zakona o porodici.</p> <p>4. Kriterijumi i procedure za promenu komponenti kao u stavu 1.5. ovog člana uređuju se relevantnog zakona o prebivalište.</p> <p style="text-align: center;">Član 33 Promena ličnog imena</p> <p>1. Državljanin može promeniti lično ime, samo</p>
--	---	---

<p>vetëm emrin apo vetëm mbiemrin, në bazë të kërkesës së tij.</p> <p>2. Personi i mitur mund të ndërrojë emrin personal, vetëm emrin apo vetëm mbiemrin, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor.</p> <p>3. Në rast të ndërrimit të emrit personal, vetëm emrit apo mbiemrit të personit të mitur i cili ka arritur moshën 10 vjeçare, kërkohet pëlqimi i tij.</p> <p>4. Ndërrimi i emrit personal gjatë adoptimit bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës mbi familjen.</p> <p>5. Ndërrimi i mbiemrit gjatë lidhjes së martesës bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës mbi familjen.</p> <p>6. Një personi nuk i lejohet ndërrimi i emrit personal, vetëm emrit, ose vetëm mbiemrit, nëse personi ndiqet penalisht ose personi është dënuar për një vepër penale, deri në përfundim të dënimit ose derisa zgjasin pasojat juridike të dënimit.</p> <p>7. Ndërrimi i emrit personal, vetëm emrit ose vetëm mbiemrit, me kërkesë të palës në procedurë administrative të organit të gjendjes civile mund të zhvillohet vetëm një (1) herë</p>	<p>only his/her first name or only his/her surname upon his/her request.</p> <p>2. A minor person may change his/her personal name, only his/her first name or only his/her last name at the request of the guardianship body.</p> <p>3. In case of changing the personal name, only the first or last name, of a minor who has reached the age of 10, his consent shall be required.</p> <p>4. The change of personal name during adoption shall be done in accordance with the provisions of the relevant Law on Family.</p> <p>5. The change of surname during matrimonial ceremony shall be done in accordance with provisions of the Law on Family.</p> <p>6. A person is not allowed to change his/her personal name, only the first name or only the last name, if legal proceedings are being carried out against him/her or if the person has been sentenced for a criminal offense, until such a sentence ends or until the legal consequences of the sentence are present.</p> <p>7. Change of the personal name, only the first name or only the last name at the request of the party in the administrative procedure of the civil status body can take place only once (1) within</p>	<p>ime ili samo prezime na osnovu svog zahteva.</p> <p>2. Maloletnik može promeniti lično ime, samo ime ili samo prezime na zahtev zakonskog zastupnika.</p> <p>3. U slučaju promene ličnog imena, samo imena ili prezimena, maloletnog lica koje je navršilo 10 godina života, potrebna je njegova saglasnost.</p> <p>4. Promena ličnog imena prilikom usvojenja vrši se u skladu sa odredbama odgovarajućeg zakona o porodici.</p> <p>5. Promena prezimena u toku sklopanje braka vrši se u skladu sa odredbama odgovarajućeg Zakona o porodici.</p> <p>6. Licu nije dozvoljeno da menja lično ime, samo ime ili samo prezime ako je lice krivično gonjeno ili je lice osuđivano za krivično delo, do prestanka kazne ili dok ne traju pravne posledice kazne.</p> <p>7. Promena ličnog imena, samo imena ili samo prezimena na zahtev stranke u upravnom postupku organa civilnog stanja može se izvršiti samo jednom (1) u roku od deset (10) godina.</p>
---	---	---

<p>brenda dhjetë (10) viteve.</p> <p>8. Ndërrimi i mbiemrit për shkak të regjistrimit apo shuarjes së martesës nuk i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 7 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Kriteret për ndërrimin e emrit personal</p> <p>1. Shtetasi i Republikës së Kosovës mund t'a ndërrojë emrin personal, vetëm emrin ose vetëm mbiemrin, në bazë të kërkesës së tij, nëse i plotëson kriteret e nenit 33 të këtij ligji, si dhe kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.1. kërkesa paraqitet personalisht nga shtetasi, ose në rast të personit të mitur nga përfaqësuesi ligjor;</p> <p>1.2. kërkesa për ndërrimin e emrit personal nuk ka karakter fytes, imoral, racist dhe nëse nuk është në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e njerëzve të tjerë, apo të vetë personit.</p> <p>2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, të huajt me qëndrim të rregullt në Republikën e Kosovës që janë të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, të cilët kanë ndërruar emrin personal në shtetin e tyre të origjinës, duhet të paraqesin kërkesë për reflektimin e ndërrimit të emrit në regjistrin e gjendjes civile, duke paraqitur dëshmi për ndërrimin.</p>	<p>ten (10) years.</p> <p>8. Change of surname due to marriage or dissolution of marriage shall not be subject to the restrictions under paragraph 7 of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Criteria for changing the personal name</p> <p>1. A citizen of the Republic of Kosovo may change his personal name, only the first name or only the last name upon his/her request, if they meet the criteria of Article 33 of this law as well as the following criteria:</p> <p>1.1. The request shall be presented personally by the citizen or in the case of a minor by the legal representative;</p> <p>1.2. The request to change the personal name shall not have an offensive, immoral, racist character, or shall not be contrary to the rights and freedoms of other people, or of the person himself/herself.</p> <p>2. With the exception of paragraph 1 of this article, foreigners with regular residence in the Republic of Kosovo who are registered in the civil status registers, and who have changed their personal name in their country of origin, shall submit a request to reflect the change of name in the civil status register, by presenting proof of the change.</p>	<p>8. Promena prezimena usled sklapanja braka ili razvoda braka ne podleže ograničenjima iz stava 7. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 34 Kriterijumi za promenu ličnog imena</p> <p>1. Državljanin Republike Kosovo može promeniti lično ime, samo ime ili samo prezime na osnovu njegovog zahteva, ako ispunjava kriterijume iz člana 33. ovog zakona kao i sledeće kriterijume:</p> <p>1.1. Zahtev podnosi lično ržavljanin, a u slučaju maloletnog lica zakonski zastupnik;</p> <p>1.2. Zahtev za promenu ličnog imena nema uvredljiv, nemoralan, rasistički karakter, ili ako nije u suprotnosti sa pravima i slobodama drugih ljudi, ili samog lica.</p> <p>2. Sa izuzetkom stava 1 ovog člana, stranci sa redovnim boravkom u Republici Kosovo koji su upisani u registre civilnog stanja, koji su promenili svoje lično ime u svojoj zemlji porekla, moraju podneti zahtev da odraze promenu. imena u matičnim knjigama, uz dokaz o promeni.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 35 Procedura e ndërrimit të emrit personal</p> <p>1. Shtetasi i cili dëshiron të ndërrojë emrit personal, kërkesën e bën në Zyrën e Gjendjes Civile ku ka vendbanimin e përhershëm.</p> <p>2. Për ndërrimin e emrit personal vendos Agjencia, përjashtimisht rasteve për ndërrim të mbiemrit për shkak të regjistrimit apo shuarjes së martesës, në të cilat raste vendos Zyra e Gjendjes Civile.</p> <p>3. Procedura dhe rregullat e detajuara për ndërrimin e emrit personal përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Procedure of changing the personal name</p> <p>1. A citizen who wants to change his/her personal name shall submit a request at the Civil Status Office where he/she permanently resides.</p> <p>2. The Agency shall decide on the change of personal name, with the exception of cases for changing the surname due to the registration or dissolution of marriage, in which cases the civil status office shall decide.</p> <p>3. The procedure and detailed rules for the changing the personal name shall be determined by a sub-legal act approved by the Minister.</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Postupak promene ličnog imena</p> <p>1. Državljanin koji želi da promeni lično ime podnosi zahtev u Kancelariji za civilno stanje u kojoj ima stalno prebivalište.</p> <p>2. O promeni ličnog imena odlučuje Agencija, osim u slučajevima promene prezimena zbog registracije ili prestanka braka, o kojima odlučuje Kancelarija za civilno stanje.</p> <p>3. Procedura i detaljna pravila za promenu ličnog imena utvrđuju se podzakonskim aktom usvojenim od strane ministra.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Ndërrimi i gjinisë</p> <p>1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me zotësi të veprimit, që është i bindur se gjinia e regjistruar në gjendjen civile nuk korrespondon me identitetin gjinor, mund të kërkojë ndërrimin e gjinisë tek Zyra e Gjendjes Civile.</p> <p>2. Kërkesa për ndërrim të gjinisë parashtrohet tek zyrtari i gjendjes civile, në cilëndo nga Zyrat e Gjendjes Civile.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Change of the sex marker</p> <p>1. Any citizen of the Republic of Kosovo with the ability to act, who is convinced that the gender registered in the civil status does not correspond to his/her gender identity, may request a gender change at the civil status office.</p> <p>2. The request for gender change shall be submitted to the civil status officer, in any of the civil status offices</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Promena markera pola</p> <p>1. Svaki sposoban građanin Republike Kosovo, koji je uveren da pol upisan u civilnom stanju ne odgovara rodnom identitetu, može zahtevati promenu pola u kancelariji civilnog stanja.</p> <p>2. Zahtev za promenu pola podnosi se službeniku civilnog stanja, u bilo kojoj od kancelarija za civilno stanje.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 37 Kriteret për ndërrimin e gjinisë</p> <p>1. Personi që bën kërkesën për ndërrimin e gjinisë, duhet të plotësojë kriteret si në vijim:</p> <p>1.1. deklaratën, përmes së cilës deklarohet se personi prej kohësh është i bindur se gjinia e regjistruar në certifikatën e lindjes nuk përputhet me identitetin e tij gjinor të jetuar nga afër dhe se dëshiron pasojat administrative dhe ligjore të ndërrimit të gjinisë në certifikatën e lindjes;</p> <p>1.2. të deklarojë se është në dijeni të pasojave administrative dhe ligjore që sjell ndërrimi i gjinisë në gjendjen civile;</p> <p>1.3. të vërtetojë se personi nuk ndiqet penalisht ose që personi nuk është dënuar për një veprë penale, deri në përfundim të dënimit ose derisa të zgjasin pasojat juridike të dënimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 37 Criteria for changing the gender</p> <p>1. A person submitting the request to change the gender must meet the following criteria:</p> <p>1.1. Statement declaring that the person has long been convinced that the gender mentioned on the birth certificate does not match his/her closely lived gender identity and that he/she wants the administrative and legal consequences of changing the gender on the birth certificate;</p> <p>1.2. declare that he/she is aware of the administrative and legal consequences of changing the gender in the civil status;</p> <p>1.3. prove that the person is not being prosecuted or the person has not been convicted of a criminal offense, until the end of the sentence or until the legal consequences of the sentence are present.</p>	<p style="text-align: center;">Član 37 Kriterijumi za promenu markera pola</p> <p>1. Osoba koja podnosi zahtev za promenu pola mora da ispunjava sledeće kriterijume :</p> <p>1.1. Izjavu, kojom se izjavljuje da je lice odavno ubeđeno da pol naveden u sertifikatu rođenja ne odgovara njegovom blisko proživljenom rodnom identitetu i da želi administrativne i pravne posledice promene pola u sertifikatu rođenja;</p> <p>1.2. da izjavi da je svestan administrativno-pravnih posledica promene pola u civilnom stanju;</p> <p>1.3. dokaže da lice nije krivično gonjeno ili da lice nije osuđivano za krivično delo, do isteka kazne ili do isteka pravnih posledica izrečene kazne.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 38 Procedura e ndërrimit të gjinisë</p> <p>1. Shtetasi i cili dëshiron të bëjë ndërrimin e gjinisë, kërkesën e bën në Zyrën e Gjendjes Civile ku e ka vendbanimin e përhershëm.</p>	<p style="text-align: center;">Article 38 Procedure of changing the sex marker</p> <p>1. A citizen who wishes to change the sex marker, shall submit the request at the Civil Status Office where he/she permanently resides.</p>	<p style="text-align: center;">Član 38 Procedura promene markera pola</p> <p>1. Državljanin koji želi da promeni oznaku pola, podnosi zahtev u Kancelariji za civilno stanje u kome ima stalno prebivalište.</p>

<p>2. Për ndërrimin e gjinisë vendos Agjencia.</p> <p>3. Gjinia mund të ndërrohet vetëm një (1) herë brenda dhjetë (10) viteve.</p> <p>4. Shtetasi mund të parashtrojë kërkesë për ndërrimin e emrit personal, për shkak të ndërrimit të gjinisë, pa iu nënshtuar kufizimit të paragrafit 7 të nenit 33 të këtij ligji.</p> <p>5. Rregullat e detajuara për ndërrimin e gjinisë përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>2. Agency shall decide on the change of sex marker.</p> <p>3. Gender change may take place only once within ten (10) years.</p> <p>4. A citizen may submit a request for changing the personal name due to the change of gender without being a subject to the restriction of paragraph 7 of article 33 of this Law</p> <p>5. The detailed rules for the changing of the sex marker shall be determined by a sub-legal act approved by the Minister.</p>	<p>2. Agencija odlučuje o promeni markera (oznake) pola.</p> <p>3. Pol se može promeniti samo jednom (1) u roku od deset (10) godina.</p> <p>4. Građanin može podneti zahtev za promenu ličnog imena zbog promene pola bez ograničenja iz stava 7 člana 33 ovog zakona</p> <p>5. Procedura i detaljna pravila za promenu markera (oznake) pola utvrđuju se podzakonskim aktom usvojenim od strane ministra.</p>
<p>KAPITULLI VII ANKESA</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 E drejta e ankesës</p>	<p>CHAPTER VII COMPLAINT</p> <p style="text-align: center;">Article 39 The Right to Complaint</p>	<p>POGLAVLJE VII ŽALBA</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Pravo na žalbu</p>
<p>1. Kundër cilitdo vendimi sipas këtij ligji lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën administrative.</p> <p>2. Për ankesat sipas paragrafit 1. të këtij neni, vendos Komisioni i Ankesave.</p> <p>3. Ministri, me akt nënligjor, përcakton</p>	<p>1. Against any decision according to the Law, a complaint shall be allowed in accordance with the rules defined in the relevant Law on General Administrative Procedure.</p> <p>2. The Complaints Committee shall decide on complaints according to paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. The Minister shall, through a sub-legal act,</p>	<p>1. Protiv bilo koje konačne odluke u skladu sa ovim zakonom, dozvoljena je žalba u skladu sa pravilima definisanim relevantnim Zakonom o upravnom postupku.</p> <p>2. Za žalbe iz stava 1. ovog člana odlučuje Komisija za žalbe.</p> <p>3. Ministar, podzakonskim aktom, utvrđuje sastav</p>

<p>përbërjen e komisionit dhe mandatin e anëtarëve të komisionit. Puna dhe procedura e Komisionit të Ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjinale në ligjin përkatës për procedurën administrative.</p>	<p>determine the composition of the committee and the mandate of the members of the committee. The work and procedure of the complaints committee shall be based on the rules defined for collegial bodies in the relevant Law on Administrative Procedure.</p>	<p>komisije i mandat članova komisije. Rad i postupak žalbene komisije zasniva se na pravilima koja su za kolegijalne organe definisana odgovarajućim Zakonom o upravnom postupku.</p>
<p>KAPITULLI VIII SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE</p>	<p>CHAPTER VIII CIVIL STATUS SERVICE</p>	<p>POGLAVLJE VIII SLUŽBA CIVILNOG STATUSA</p>
<p>Neni 40 Natyra dhe funksioni</p>	<p>Article 40 Nature and Function</p>	<p>Član 40 Priroda i funkcija</p>
<p>1. Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror.</p> <p>2. Shërbimi i gjendjes civile në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes lokale.</p>	<p>1. The Civil Status Service is a unique state service.</p> <p>2. The civil status service in the sense of this law shall be exercised as a delegated function also by local government bodies.</p>	<p>1. Služba civilnog statusa je jedinstvena državna služba.</p> <p>2. Službu civilnog statusa u smislu ovog zakona kao poverenu funkciju obavljaju i organi lokalne uprave.</p>
<p>Neni 41 Organizimi i shërbimit të gjendjes civile</p>	<p>Article 41 Organization of Civil Status Service</p>	<p>Član 41 Organizovanje službe civilnog statusa</p>
<p>1. Shërbimi i gjendjes civile është i organizuar në:</p> <p>1.1. nivelin qendror të shërbimit të gjendjes civile, respektivisht Agjencinë;</p> <p>1.2. nivelin lokal të shërbimit të gjendjes civile, respektivisht Zyrat e Gjendjes Civile;</p>	<p>1. Civil status service shall be organized at:</p> <p>1.1. central level of civil status service, respectively Agency;</p> <p>1.2. local level of civil status service, respectively Civil Status Offices;</p>	<p>1. Služba civilnog statusa je organizovana na:</p> <p>1.1. centralnom nivou službe civilnog statusa, odnosno u Agenciji;</p> <p>1.2. lokalnom nivou službe civilnog statusa, odnosno kancelarijama civilnog statusa;</p>

<p>1.3. shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 42 Agjencia e Regjistrimit Civil</p> <p>1. Agjencia e Regjistrimit Civil është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.</p> <p>2. Organizimi, strukturimi, mbikëqyrja, udhëheqja dhe autorizimet e përgjithshme të Agjencisë, rregullohen me ligj të veçantë.</p>	<p>1.3. civil status service in the diplomatic and consular missions of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 42 Civil Registration Agency</p> <p>1. Civil Registration Agency shall be the highest body of civil status service.</p> <p>2. Organization, structuring, supervision, management and overall powers of Agency shall be regulated by a special law.</p>	<p>1.3. službi civilnog statusa u diplomatsko-konzularnim predstavništvima Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 42 Agencija za civilnu registraciju</p> <p>1. Agencija za Civilnu Registraciju je najviši organ službe civilnog statusa.</p> <p>2. Organizovanje, strukturisanje, nadzor, rukovođenje i opšta ovlašćenja Agencije uređuju se posebnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 43 Detyrat e Zyrave të Gjendjes Civile</p> <p>1. Zyrat e Gjendjes Civile kanë këto detyra:</p> <p>1.1. përditësojnë regjistrin qendror të gjendjes civile;</p> <p>1.2. krijojnë dhe mbajnë aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;</p> <p>1.3. lëshojnë numrin personal dhe dokumentet e gjendjes civile, siç përcaktohet me këtë ligj;</p> <p>1.4. grumbullojnë dhe përpunojnë të</p>	<p style="text-align: center;">Article 43 Duties of Civil Status Offices</p> <p>1. Civil status offices shall have these duties:</p> <p>1.1. update the central civil status registry;</p> <p>1.2. create and maintain acts of births, marriages and deaths;</p> <p>1.3. issue the personal number and civil status documents as defined by this law;</p> <p>1.4. collect and process biometric data of</p>	<p style="text-align: center;">Član 43 Dužnosti kancelarija civilnog statusa</p> <p>1. Kancelarije Civilnog Statusa imaju sledeće dužnosti:</p> <p>1.1. ažuriranje centralnog registra civilnog stanja;</p> <p>1.2. kreiranje i održavanje akte rođenja, braka i umrljih;</p> <p>1.3. izdaju lični broj i isprave o građanskom statusu kako je utvrđeno ovim zakonom;</p> <p>1.4. prikupljaju i obrađuju biometrijske</p>

<p>dhëna biometrike të qytetarëve në zbatim të autorizimeve të tyre sipas këtij ligji;</p> <p>1.5. kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, siç përcaktohet me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 44 Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore</p> <p>1. Zyrtarët e gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin e gjendjes civile për shtetasit e Republikës së Kosovës që janë me banim jashtë Republikës së Kosovës, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe në dispozitat e tjera ligjore.</p> <p>2. Mënyra, kushtet dhe rregullat e detajuara për zbatimin e këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>citizens;</p> <p>1.5. perform civil status service actions, as defined by this law and the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 44 Duties of the civil status service in the diplomatic and consular missions</p> <p>1. Civil status officials at diplomatic and consular missions shall administer the documentation and carry out actions in the Civil Status Registry for citizens of the Republic of Kosovo, who reside outside the Republic of Kosovo, according to the provisions of this law and other legal provisions.</p> <p>2. The manner, conditions and detailed rules for the implementation of this Article are set by a sub-legal act approved by the Minister.</p>	<p>podatke građana;</p> <p>1.5. obavljaju postupke službe civilnog statusa kako je utvrđeno ovim zakonom i važećim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 44 Dužnosti službe civilnog statusa u diplomatsko-konzularnim predstavništvima</p> <p>1. Službenici civilnog statusa u diplomatsko-konzularnim u diplomatsko-konzularnim upravljaju dokumentacijom i obavljaju radnje u registru civilnog statusa za državljane Republike Kosovo, koji borave van Republike Kosovo, prema opredeljenjima donetim u ovom zakonu i drugim zakonskim odredbama.</p> <p>2. Način, uslovi i detaljna pravila za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom usvojenom od strane ministra.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 45 Zyrtari i gjendjes civile</p> <p>1. Të drejtat dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve në regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i ka vetëm zyrtari i gjendjes civile.</p> <p>2. Zyrtari i gjendjes civile, sipas paragrafit 1 të</p>	<p style="text-align: center;">Article 45 Civil Status Official</p> <p>1. According to this law, only the civil status official shall have the rights and responsibilities for performing actions in the civil status registers.</p> <p>2. The civil status official, according to</p>	<p style="text-align: center;">Član 45 Službenik civilnog statusa</p> <p>1. Prema ovom zakonu, samo službenik civilnog statusa ima prava i odgovornosti za obavljanje radnji u registrima civilnog statusa.</p> <p>2. Službenik civilnog statusa prema stavu 1. ovog</p>

<p>këtij neni, duhet të jetë i certifikuar për të kryer veprime në regjistrat e gjendjes civile.</p> <p>3. Kushtet dhe rregullat për zbatimin e këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor nga ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 46 Mbikëqyrja dhe inspektimi</p> <p>Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe inspektimi i Zyrave të Gjendjes Civile bëhet nga njësia kompetente në kuadër të Ministrisë.</p>	<p>paragraph 1 of this Article, must be certified to perform actions in the civil status registries.</p> <p>3. The conditions and rules for the implementation of this Article, are defined by a by-law by the minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 46 Supervision and Inspection</p> <p>The supervision of the implementation of this law and the inspection of civil status offices shall be done by the competent unit within the Ministry.</p>	<p>člana mora biti certificiran za obavljanje radnji u registrima civilnog status.</p> <p>3. 3. Uslove i pravila za sprovođenje ovog člana podzakonskim aktom utvrđuje ministar.</p> <p style="text-align: center;">Član 46 Nadzor i inspekcijski nadzor</p> <p>Nadzor nad sprovođenjem ovog zakona i inspekcijski nadzor kancelarija civilnog stanja vrši nadležna jedinica u Ministriju.</p>
<p>KAPITULLI IX DISPOZITAT NDËSHKUESE</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Gjobat</p> <p>1. Me gjobë dënohet personi fizik dhe/apo juridik për këto shkelje:</p> <p>1.1. për mos deklarim të lindjes apo të vdekjes, me gjobë prej pesëdhjetë (50) Euro dënohet personi përgjegjës i personit juridik që është kompetent për deklarim të lindjes apo të vdekjes së personit sipas obligimit në nenin 10 dhe 16 të këtij ligji.</p> <p>1.2. për mos deklarim të lindjes apo të</p>	<p>CHAPTER IX PUNITIVE PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Fines</p> <p>1. A natural and/or legal person shall be punished with a fine for these violations:</p> <p>1.1. for non-declaration of birth or death, a natural person who exercises individual business and who is competent to declare the birth or death of the person according to the provisions of this law, shall be punished with a fine of fifty (50) euros;</p> <p>1.2. for non-declaration of birth or death,</p>	<p>POGLAVLJE IX KAZNENE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Novčane kazne</p> <p>1. Novčanom kaznom kažnjava se fizičko i/ili pravno lice za sledeće prekršaje:</p> <p>1.1. za neprijavlivanje rođenja ili smrti kazniće se novčanom kaznom od pedeset (50) evra za fizičko lice koje obavlja individualno poslovanje i koje je nadležno prijavljivanje rođenja ili smrti lica prema odredbama ovog zakona;</p> <p>1.2. za neprijavlivanje rođenja ili smrti</p>

<p>vdekjes, dënohet me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro institucioni që është kompetent për deklarim të lindjes apo të vdekjes së personit sipas dispozitave të këtij ligji.</p>	<p>the institution that is competent for declaring the birth or death of the person according to the provisions of this law, shall be punished with a fine of fifty (150) euros.</p>	<p>kazniće se novčanom kaznom od sto pedeset (150) evra, institucija koja je nadležna za prijavljivanje rođenja ili smrti lica prema odredbama ovog zakona.</p>
<p>KAPITULLI X DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE</p>	<p>CHAPTER X FINAL PROVISIONS</p>	<p>POGLAVLJE X ZAVRŠNE ODREDBE</p>
<p>Neni 48 Shfuqizimet</p>	<p>Article 48 Repaling</p>	<p>Član 48 Stavljanje van snage</p>
<p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet:</p> <p>1.1. Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile; dhe</p> <p>1.2. Ligji Nr. 02/L-118 për Emrin Personal.</p>	<p>1. With the entry into force of this law, the following shall be repealed:</p> <p>1.1. Law No. 04/L-003 on Civil Status; and</p> <p>1.2. Law No. 02/L-118 on Personal Name.</p>	<p>1. Stupanjem na snagu ovog zakona stavlja se van snage:</p> <p>1.1. Zakon br. 04/L-003 o civilniom statusu; i</p> <p>1.2. Zakon br. 02/L-118 o ličnom imenu.</p>
<p>Neni 49 Aktet nënligjore</p>	<p>Article 49 Sub-legal acts</p>	<p>Član 49 Podzakonski akti</p>
<p>1. Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj miratohen brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p> <p>2. Me kusht që nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, aktet nënligjore në fuqi do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara në këtë ligj.</p>	<p>1. The sub-legal acts defined in this law shall be approved six (6) months after entry into force of this law.</p> <p>2. Provided that they are not contrary to the provisions of this law, the sub-legal acts in force shall be applied until the issuance of the sub-legal acts defined in this law.</p>	<p>1. Podzakonski akti utvrđeni ovim zakonom usvajaju se u roku od šest (6) meseci nakon stupanja na snagu ovog zakona.</p> <p>2. Pod uslovom da nisu u suprotnosti sa odredbama ovog zakona, do donošenja podzakonskih akata predviđena ovim zakonom primenjivaće se važeći podzakonski akti.</p>

<p>3. Përdorimi i kopjeve të certifikuara të regjistrave origjinalë themeltarë të gjendjes civile të Kosovës të cilët janë marrë nga ish-pushteti serb para qershorit 1999, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 50 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Glauk Konjufca</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p>3.The use of certified copies of the principal civil status registries of Kosovo which were taken by the former Serbian government before June 1999 shall be regulated by a sub-legal act issued by the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 50 Entry into force</p> <p>This law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Glauk Konjufca</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p>Speaker of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p>3. Upotreba overenih kopija originalnih osnivačkih registara civilnog statusa na Kosovu koje je uzela bivša Vlada Srbije pre juna 1999. godine. uređuje se podzakonskim aktom ministra.</p> <p style="text-align: center;">Član 50 Stupanje u snagu</p> <p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Glauk Konjufca</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>
--	--	---